



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 12 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kalimin e Një Kërkese Trupit Gjykues II

Gjykatësve të Trupit Gjykues II:

Gjykatës Çarls Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor (rezervë)

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtësit kujdestar të Salih Mustafës:

Laurens van Pajenbruk

Mbrojtjes së Viktimave:

Ani Pues

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke u bazuar në rregullën 81(1)(a), (2)(b) dhe (4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), me anë të këtij vendimi i kalon për gjykim Trupit Gjykues II Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Versionet Konfidenciale të Aktgjykimit dhe të Aktgjykimit të Apelit¹ ("Kërkesa").

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues I shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin, ndër të tjera, e shpalli z. Salih Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.² Trupi Gjykues e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.³

2. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykues I lëshoi Versionin e Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, me të cilin e urdhëroi z. Mustafa t'u paguante 207.000 euro viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor si kompensim për dëmin e shkaktuar.⁴

3. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Versionin e Redaktuar Publik të Aktgjykimit të Apelit, me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës së ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi, pjesërisht, apelin e z. Mustafa kundër dënimit të tij.⁵ Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁶

¹ F00042 Kërkesë e Prokurorisë për Qasje në Versionet Konfidenciale të Aktgjykimit dhe të Aktgjykimit të Apelit, 8 shkurt 2024.

² KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykimi, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2023.

³ Aktgjykimi, para. 831.

4. Më 8 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti Kërkesën, me të cilën kërkoi "autorizim për qasje dhe përdorim, mbi bazë konfidenciale, të versioneve konfidenciale të Aktgjykimit dhe Aktgjykimit të Apelit në çështjen *Mustafa*"⁷ për "kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit" në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*⁸ dhe për të vendosur, ndër të tjera, nëse do të kërkojë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në Aktgjykimet e përmendura sikurse përcaktohet në rregullën 157(2) të Rregullores.⁹

II. DISKUTIM

5. Sipas rregullës 81(1)(a) të Rregullores, pas urdhërimit prej një paneli të masave mbrojtëse në lidhje me një dëshmitar, viktimë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, ose persona të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë prej një dëshmitari, këto masa mbeten në fuqi *mutatis mutandis* në çfarëdo procesi të mëpasshëm para Dhomave të Specializuara ose në një juridiksion tjetër, përveçse dhe deri kur të ndryshohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë rregull.

6. Sipas rregullës 81(2)(a) të Rregullores, kërkesa për ndryshimin e masave mbrojtëse i paraqitet panelit i cili ka urdhëruar masat mbrojtëse. Duke qenë se nuk ka panel të caktuar për çështjen, sipas rregullës 81(2)(b) të Rregullores, pala duhet t'ia paraqesë kërkesën panelit të caktuar me procesin e mëpasshëm. Në rrethanat aktuale, Kërkesa duhet t'i paraqitet Trupit Gjykues II të caktuar në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, për të cilën çështje Prokuroria kërkon qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimit dhe Aktgjykimit të Apelit në çështjen *Mustafa*.¹⁰

⁴ KSC-BC-2020-05/F00517/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 prill 2023, para. 283.

⁵ KSC-CA-2023-02/F00038/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023, para. 484.

⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

⁷ Kërkesa, para. 1.

⁸ Kërkesa, para. 1.

⁹ Kërkesa, para. 2.

¹⁰ Kërkesa, para. 1-4.

7. Sikurse përcaktohet në rregullën 81(4) të Rregullores, para se të marrë vendimin në lidhje me kërkesën e paraqitur sipas kësaj rregulle, Trupi Gjykses II këshillohet me gjykatësin që ka urdhëruar masat mbrojtëse dhe që është ende në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

II. VENDIM

8. Bazuar në sa më lart, Kryetarja

IA KALON Kërkesën Trupit Gjykses II; dhe

URDHËRON Njësinë për Administrimin e Gjykatës t'ia dorëzojë Kërkesën Trupit Gjykses II.

_____/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 12 shkurt 2024
Në Hagë, Holandë